



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Seksioni pranveror

Nënkomisioni për Mandate, Imunitet dhe Rregullore të Kuvendit
Më 04.02.2013, në orën 11:00

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj, kryetar, Gëzim Kelmendi dhe Jasmina Zhivković.

Nga Zyra mbështetëse: Fehmi Hyseni, Advie Morina dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Armend Zemaj, kryetar i Nënkomisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
3. Shqyrtimi dhe amendamenti i Projekt-rregullores të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Nënkomisioni miratoi rendin e ditës, pa ndryshime.

Meqenëse nuk kishte kuorum anëtarët e pranishëm u pajtuan që të mos procedohet me rendin e ditës, por vetëm të konsultohen për veprimet që duhet të ndërmerren me qëllim të shqyrtimit të rekomandimeve nga komisionet e përhershme.

Armend Zemaj- Tha se lidhur me Projekt-rregulloren në seancën e kaluar, kryetari i Kuvendit të Kosovës, ka kërkuar të njoftohet deri ku është proceduar me shqyrtimin dhe amendamentimin e Rregullores së Kuvendit të Kosovës.

Nënkomisioni, sa i përket Rregullores së Kuvendit të Kosovës, e ka përfunduar punën si Komision Funkcional, nga se komisionet e përhershme janë vonuar me shqyrtimin e raporteve dhe me dërgimin e rekomandimeve.

Komisioni i Buxhetit dhe Financave sugjeron dhe njëherit kërkon nga Komisioni legjislativ në bashkëpunim me Drejtorinë për buxhet dhe pagesa të administratës së Kuvendit, të bëjë vlerësimin dhe ta bashkëngjis Deklaratën për ndikim buxhetor të Projekt-rregullores.

Nënkomisioni nxori përfundimin si vijon:

Nënkomisioni për mandate, imunitete dhe rregullore të Kuvendit, duke u bazuar në përfundimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, të datës 28.08.2012, kërkon nga kjo drejtori të bëjë përlogaritjen e implikimeve buxhetore në rregulloren e Kuvendit.

Ndërsa Komisioni për Integritet Evropian thotë se Projekt -rregullorja e Kuvendit nuk është në kundërshtim me parimet bazë të Acquis komunitare. Amendamentet e propozuara nga grupi i grave deputete nuk janë miratuar, sepse janë në kundërshtim me parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së.

Ai theksoi se edhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim e ka shqyrtuar dhe njëherit konstaton se nuk i shkel dhe nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Komisioni i shqyrtoi amendamentet e propozuara të Komisionit Funkcional dhe i miratoi, ndërsa amendamentet 25 dhe 26 nuk i miratoi. Kryetari i Nënkomisionit do të konsultohet me kryetarin dhe do të japë sqarim lidhur me nenet 26 dhe 27.

?Duke theksuar se punën e nënkomisionit për hartimin e e P/rregullores së Kuvendit, dhe hartimin e Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, në veçanti e ka mbështetur OSBE-ja me ekspertët e vetë, NDI me ekspertet e saj, kabinetin e Kryetarit të Kuvendit me këshilltarët e vetë, përfaqësuesit e OJ-ve si dhe administratën e Kuvendit.

Nënkomisioni ne vazhdim i shqyrtoi amendamentet dhe rekomandimet e komisioneve kryesore të projektrregullores së Kuvendit miratojë raportin me rekomandime të Nënkomisionit për Mandate, Imunitet dhe Rregulloren, lidhur me Projekt-rregulloren e Kuvendit të Kosovës, dhe njëherit e dergoi komisionin për Legjislacion, i cili do të shqyrtojë amendamentet dhe rekomandimet nga komisionet kryesore, dhe njëherit ta procedojë për miratim në seancën plenare.

Të ndryshme

Kryetari Zemaj, lidhur me Projekt -ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit tha se do të organizohet një seancë e dëgjimit publik.

Në fund nxori përfundimin se më 13.02.2013, do mbahet dëgjimi publik, në të cilin do të ftohen përfaqësuesit e:

Qeverisë së Kosovës,
Ministritë së Drejtësisë,
Ministritë së Financave,
Gjykatës Kushtetuese,
Avokatit të Popullit
Shoqërive Civile,
Asociacionit të Komunave,

Ish- deputetët e legjislaturave të viteve 1990-1999 (Iljaz Ramajli, Ramadan Kelmendi dhe Kolë Berisha),
OSBE-së dhe NDI-së.

Nënkomisioni kërkoj që të nxjerrët një statistikë e moshës për katër legjislacionet, edhe për legjislacionin e vitit 1990, e veçantë.

Gëzim Kelmendi- Theksoi se ne, si grup parlamentar, kemi qëndrim kundër pensionit sublimantar, për shkak të kushteve tejet të vështira ekonomike për gjithë popullatën e Kosovës. Gjithashtu theksoi se ende nuk është rregulluar sigurimi pensional për qytetarët e Kosovës.

Armendi Zemaj, kryetar, theksoi se në të gjitha shtetet e rajonit çështjen e pensionit suplementar e kanë të rregulluar. Ai propozoi që ligji të hartohet dhe ta përfundojë në të ardhmen.

Mbledhja përfundoi në orën 12.30.

Kryetar i Nënkomisionit

Armend Zemaj